

Vendim nr. 10 datë 19.01.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Marjana Semini, Anëtare

Sandër Beci, Anëtar

në datën 19.01.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 57 (A) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ARBEN BERBERI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-2372 (379), datë 07.06.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, pika 1, 42, pika 1, 131, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pikat 1 dhe 3, shkronjat “b” dhe “c”, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 28, 29, 30, 39, 42 dhe 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Arben Berberi është pronar i një trualli prej 600 m² të ndodhur në qytetin e Pogradecit dhe me kontratën e sipërmarrjes, datë 23.11.2006, i ka dhënë porosi sipërmarrësit,

shoqërisë “Krek” sh.p.k. (*shoqëria e ndërtimit*) për ndërtimin e një banese 7-katëshe + bodrume, në përputhje me projektin e miratuar nga Këshilli i Rregullimit të Territorit, Bashkia Pogradec. Sipas kontratës, në përfundim të ndërtimit, kërkuesi do të përfitonte 25% të sipërfaqes së ndërtimit, ndërsa shoqëria e ndërtimit do të përfitonte 75% të sipërfaqes së ndërtimit dhe në rast të miratimit të kërkesës për shtim kati, përqindja e ndarjes së sipërfaqes së ndërtimit do të ishte përsëri 25% me 75%.

2. Nga ana tjetër, shoqëria e ndërtimit (sipërmarrësi) në datën 26.12.2007 ka lidhur një kontratë sipërmarrjeje me shtetasin A.K. (me cilësinë e porositesit), sipas së cilës sipërmarrësi do të ndërtonte një apartament banimi me sipërfaqe 70 m² në katin e dytë të një pallati të ndodhur në qytetin e Pogradecit. Sipas kontratës, koha e përfundimit të ndërtimit do të ishte data 30.06.2008. Në kushtet kur shoqëria e ndërtimit nuk ka dorëzuar objektin në përfundim të afatit, shtetasi A.K. i është drejtuar gjykatës me padi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, me vendimin nr. (839) 480, datë 01.06.2012, ka vendosur pranimin e pjeshëm të padisë dhe detyrimin e shoqërisë së ndërtimit të përmbushë detyrimin kontraktor. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim shoqëria e ndërtimit.

3. Gjithashtu, edhe kërkuesi, duke pretenduar se shoqëria e ndërtimit nuk i është përmbajtur kontratës dhe ka lidhur kontratë porosie për një apartament që i takon atij, ka paraqitur padi në gjykatë me objekt, ndër të tjera, sigurimin e padisë dhe pavlefshmërinë e kontratës së datës 26.12.2007. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, me vendimin nr. (401)-167, datë 26.05.2014, ka vendosur pushimin e gjykimit.

4. Mbi ankimin e kërkuetit, Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 404, datë 18.12.2014, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, pranimin e padisë dhe detyrimin e shoqërisë ndërtimore të plotësojë detyrimet sipas kontratës së sipërmarrjes, datë 23.11.2006, si dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së datës 26.12.2007. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs shtetasi A.K. dhe kundërrekurs kërkuesi.

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-2372 (379), datë 07.06.2023, ka vendosur prishjen e vendimeve të të dyja gjykatave dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me një tjetër trup gjykues.

6. Në datën 04.10.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me kërkesën sipas objektit, e cila, pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 23.11.2023.

II

Pretendimet e kërkuessit

7. **Kërkuessi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i kundërshtuar është rrjedhje e një procesi jo të rregullt ligjor, pasi në rastin e tij plotësohen të dyja elementet e domosdoshme të ekzistencës së padisë, si interesi i ligjshëm, ashtu edhe legjitimitimi i tij për të vepruar në kushtet kur ai pretendon për rivendosjen e një të drejte. Disponimi i gjykatës së shkallës së parë bie ndesh me dispozitat procedurale për pushimin e gjykimit që lidhen me argumentin se padia nuk mund të ngrihet, ndërkohë që gjykata e apelit ka çmuar se hetimi është i plotë dhe nuk ka vend për kthimin e çështjes, dhe se shoqëria nuk ka përmbushur detyrimet kontraktore. Sipas kërkuessit, nga provat shkresore dhe shkencore rezultojnë se ai e ka pasurinë e ligjshme.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuessit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

9. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuessi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

10. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuessi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin është dhënë vendimi gjyqësor i kundërshtuara prej tij, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “F”, i Kushtetutës, sipas të cilit individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 15, datë 07.05.2018; nr. 31, datë 25.05.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Në thelb, ky rregull synon t’u japë organeve publike dhe, në veçanti, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit. Ana tjetër e rregullit të shterimit të mjeteve juridike përfshin detyrimin e vetë individit që të tregojë kujdesin dhe vëmendjen e duhur për të paraqitur kërkesa, kundërshtime ose ankime te organet publike dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për rrethanat që mbështesin pretendimet për cenimin e të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Kolegji konstaton se kërkuesi ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë, duke pretenduar cenimin e procesit të rregullt ligjor, pasi në rastin e tij plotësohen të dyja elementet e domosdoshme të ekzistencës së padisë, si interesi i ligjshëm, ashtu edhe legjitimitimi i tij për të vepruar në kushtet kur ai pretendon për rivendosjen e një të drejte. Sipas, tij, disponimi i gjykatës së shkallës së parë bie ndesh me dispozitat procedurale për pushimin e gjykimit që lidhen me argumentin se padia nuk mund të ngrihet, ndërkohë që gjykata e apelit ka çmuar se hetimi është i plotë dhe nuk ka vend për kthimin e çështjes dhe se shoqëria nuk ka përmbushur detyrimet kontraktore. Ndërkohë, vendimi i kundërshtuar nga kërkuesi i referohet një procesi civil, i cili nuk është përmbyllur në themel, pasi sipas dispozitivit të vendimit të Gjykatës së Lartë çështja është kthyer për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë, që do të thotë se nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm ende nuk ka vlerësime përfundimtare ndaj shkaqeve për të cilat është ngritur padia dhe mjetet e ankimit (ankimi dhe rekursi). Në këto kushte, Kolegji çmon se vendimi objekt kundërshtimi nuk mund të konsiderohet përfundimtar për efekt të gjykimit kushtetues.

13. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, për rrjedhojë kërkesa nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.